



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 628/2 prot

Datë 12.03.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-93886-01-26-2024, me objekt “*Shërbimi i dekorit*”, me fond limit 9,647,356 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK me NIPT (L82523203F), me adresë: Lagja “Luigj Gurakuqi”, Bulevardi “Aqif Pasha”, Hotel “Skampa”, Kati 5, Nr.303, Elbasan
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kuçovë, me adresë: Sheshi “18 Tetori”, Blloku Nr 1, Lagja “Tafil Skëndo”, Kuçovë

Në datën 11.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. aplikimi të ankesës online A/2024/3896 datë 11.03.2024 dhe me nr. protokolli 628/2024, e operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-93886-01-26-2024, me objekt “*Shërbimi i dekorit*”, me fond limit 9,647,356 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:  
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik nr. A/2024/3896 datë 11.03.2024 dhe me nr. protokoli 628/2024. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

*“Nuk ploteson piken 2.3.1 te DST-se per te provuar pervojat e meparshme te ngjashme per tre vitet e fundit. Nuk ploteson piken 2.3.2 te DST-se pasi nga ana e operatorit ne formularin e vetdeklarimit ka deklaruar se nuk disponon punonjes ose drejtues teknik qe te jete ne listpagesen e shoqerise per sherbimet publike (sherbime dekorit) leshuar nga Bashkia per personat juridik, ose sherbimi i dekorit, Kategoria 14/d (leshuar nga ish MPPT per personat fizik.”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 12.03.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**